



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2019:123952

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06750325

P.nr. 06/2025

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari Rustem Begolli, me zyrtarën ligjore Blerta Bekteshi, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurit L. S., për shkak të veprës penale Rezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme nga neni 380 par.6 të KPRK-së , i akuzuar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.1671/2018 të datës 26.07.2018, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datë 22.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

H U D H E T akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.1671/2018 të datës 26.07.2018 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit:

L. S. nga i ati H.dhe të ëmës Xh. e gjinisë A., i lindur me datë në fshatin Rahovicë, KK Ferizaj ku edhe jeton, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, Rezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme nga neni 380 par.6 të KPRK-së, pasi që ka arritur **parashkrimi absolut** i ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë departamenti i përgjithshëm ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit L. S. , i akuzuar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.1671/2018 të datës 26.07.2018, Rezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme nga neni 380 par.6 të KPRK-së.

Kjo lëndë ka qëndruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan prej datës 06.08.2018 nga momenti i pranimit, ndërsa në Gjykatë në Graqanicë tek gjyqtari ka aritur me datë 22.01.2025, pasi që janë kaluar të gjitha fazat e konfirmimit të aktakuzës dhe me të njëjtën është filluar me seanca gjyqësore , ndërsa gjyqtari i çështjes në Lipjan me aktvendimin P.nr.418/18 të

datës 14.01.2025 të njejtën e ka shpallur jo kompetente në aspektin teritorial, dhe e njehta lëndë është proceduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Graqanicë,

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të lëndës dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret ka arritur afati kohor i ndalesës absolute të ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 106 par.1 pika 1.5 të KPK-së, vepra penale e cila është e dënueshme më shumë se një 1 vitë burgim parashkruhet kur të kanë kaluar 3 vite nga data e kryerjes së veprës penale kurse sipas dispozitave të nenit 107 par. 8 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo raste kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vite nga koha e kryerjes së veprës penale ngase vepra penale është kryer me dt: 24.03.2018 ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur me dt:24.03.2024.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të hedhet akuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 106 par.1.5, 107 par 8 të KPK-së, si dhe nenin 253 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-Departamenti i
Përgjithshëm Penal,
P.nr.06/2025, datë 22.01.2025**

Zyrtarja Ligjore,
Blerta Bekteshi

Gjyqtari,
Rrustem Begolli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqesin ankesë personat e autorizuar, brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.